

**STATUTI**  
**“Albanian Soul” shpk**  
**SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

Ne këtë statut

- "Ligji" Eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";

"Statuti" është Statuti i shoqërisë;

**Kreu I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më 08.04.2024 (8 Prill 2024), une, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar me Emrin e Shoqërisë: *“Albanian Soul”*

dhe Emer Tregtar: *“Albanian Soul”*

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Z. Gent Fezo** shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.02.1974, lindur në Elbasan dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i dokumentit të identitetit tip kartë me Nr. Personal H40205177S.

**Neni 2:**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

> Kamping, Shetitje turistike, bar-restorant e turizem. Shërbime restoranti, linje restorantesh, linja shërbimi ushqimi te shpejte, shërbim hotelerie, kafe - bar, supermarkete, minimarkete, tregtim me shumice dhe pakice te produkteve ushqimore, industriale, te produkteve kozmetike etj. Agjenci udhëtimi, agjenci informacioni turistik e shërbime te ngjashme me to. Agjenci imobiliare, autoskolle si dhe çdo aktivitet tjetër te lejuar nga legjislacioni ne fuqi. Te operoje ne fushen e ndërtimit, transport brenda dhe jashte vendit, tregtimit shumice pakice import-export mallra te ndryshme.

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë:

Kohëzgjatja e Shoqërisë **“Albanian Soul” shpk** vendoset për një periudhë të pacaktuar kohore nga data e regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

**Neni 4:**

**Selia**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Ndërtese 1-kateshe, Zona Kadastrale 1952, Himare, Vlore**

(2) Adresa e shoqërisë per qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):





**Kreu II**  
**KAPITALI, KONTRIBUTET E KAPITALIT THEMELTAR,**  
**SHPËRNDARJA E KUOTAVE ETJ.**

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

(I) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 (Njeqind) Leke. Pjesemarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme.

Kontributi i kapitalit themeltar ka ndodhur si vijon:

- a) Ortaku themelues **Gent Fezo**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 (njeqind) Lekë, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku i vetem ka depozituar kapitalin themeltar prej 100 (njeqind) leke ne nje llogari bankare.

**Neni 6:**

**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga asambleja e ortakëve e një eksperti kontabël të regjistruar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjten masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**

**Transferimi i kapitalit**


Kuotat mund t'iu transferohen paleve të treta tërësisht ose pjesërisht nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin themeltar;
- b) Blerjes - shitjes së kuotave;
- c) Trashgimisë;
- d) Dhurimit;
- d) Çfaredo mëtej tjetër të parashikuar nga ligji

Na rastin e transferimit të ndonjë titulli të kuotave ndaj palëve të treta, ortakët e tjerë mund të preferohen në blerjen e kuotave në proporcion me kuotat e tyre në të njëjtin cmim dhe nën kushte të njëjta të ofruara nga pala e tretë.

Në këtë rast ortakët duhet t'iu komunikojë ortakëve të tjerë cmimin e ofruar nga pala e tretë, duke siguruar prova me shkrim të ofertes, dhe ortakët e tjerë do të kenë 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës për të informuar ortakun shites dhe ortakët e tjerë për vullnetin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Kur ortakët e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit kohor, do të thotë se kanë hequr dorë nga e drejta e parablerjes në favor të tyre.

Nëse një prej ortakëve të tjerë, që ofrohet për të blerë në parablerje pjesën e tij të kuotave të ortakut të shitjes, nuk synon të ushtrojë të drejtën e parablerjes, ortakët e tjerë të cilët kanë ushtruar tashmë pjesën e tyre të drejtën e tyre të parablerjes mund të zgjerohen këtu të drejtë për të gjitha ose një pjesë të kuotave të ofruara në parablerje për ortakun i cili nuk synon të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes.





Ne rast se me shume ortake deshirojne te zgjerojne te drejten e parablerjes, te ofruara për ortakun i cili nuk synon te ushtroje te drejtën e tij te parablerjes ne mosmarreveshje do te ndahet ne pjesë te barabarta.

Ne rastin kur vetem njeri ortak deshiron te zgjeroje te drejtën e tij te parablerjes, parablerjes ne mosmarrëveshje ofruar per ortakun i cili nuk synon te ushtroje te drejtën e tij te parablerjes, do të transferohet plotësisht ne te githa ose pjesen qe ai synon per te blere.

Ne kete aspekt, anëtarët deshirojne te zgjerojne te drejtën e tyre te parablerjes duhet të njoftojne ortakun shites, vendimin e tij brenda pesëmbëdhjete (15) diteve nga marrja e njoftimit te mungeses per te ushtruar te drejtën e parablerjes,

Të githa keto komunikime duhet te jenë me shkrim.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

##### **Neni 8**

##### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e mëposhtme

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- b) ndryshimet e statutit,
- c) emërimin e shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te regjistruar;
- (d) pereaktivimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat \*c\* dhe "e" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (c) miratimin e pasayrave financiare vjetore dhe te raporeve te ecurise se veprimtarise:
- ë) shperndarjen e fitimeve vjetore
- f) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- h) perfaqesimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- j) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- k) çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e përgjithshme, ne bazë te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqësues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per me mbledhie te asamblesë se përgjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njëjtin rend dite.

Vendimet e shumices te Asamblese jane detyruese per ortake qe mungojne ose jane kunder, por kane te drejten e ankimit ne rastet, afatet dhe format e parashikuara nga ligji.





## Neni 9

### Menyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja duhet të thirret nepërmjet njoftimit me leter rekomande që duhet t'u dërgohet ortakëve - në adresën që rezultojnë në Librin e Ortakëve ose nepërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përcaktuar më lart, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 11

### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

## Neni 12

### Perjashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes nëse asambleja e përgjithshme mer vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;



c) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakun, te cilin perfaqeson.

### Neni 13

#### Administrimi

(1) Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertëritjeje. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare meme, sipas përcaktimit te nenit 207 te këtij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqërie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte i pavlefshëm.

(3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqërise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese së Pergjithshme.

Te dhënat e identifikimit: (mbiemrat, emrat, adresat):

- 1) - Administratori i shoqërisë: **GENT FEZO**, atësia Feta, shtetas shqiptar, me numër personal identifikimi H40205177S i datëlindjes 05.02.1974, lindur në Elbasan dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me afat emërimi 5 vjeçar.

### Neni 14

#### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kane te drejte e detyrohen te:

a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikaten tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;

b) perfaqesojne shoqerine tregtare;

c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqerise;

4) pergatisin dhe nënshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet për shpërdarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;

d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohën e duhur për rrethanat, qe kercënojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhënat e detyreshme te shoqërise, sic parashikohet ne ligji in per Qendren Kombëtare te Regjistrimit;

e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

e) kryejne detyra te tjera te percaktuara në ligji dhe ne statut.


Administratorët jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqërisë nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me ta larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vere me te larte se 5 per qind te aseteteve re shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara

Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.





Asambleja e përgjithshme mund të shikarë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lichen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tjerëve, për shkelje (e ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dem shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Perveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tija me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave I e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshperblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kerkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar të dëmshperblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividende;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

5) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditesit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë.





## Kreu IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET KONTABEL

### Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### Neni 17 Ekspertët Kontabel

Nese eshte e nevojshme apo te kerkohet nga ligji, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave te shoqerise do ti besohet nje audituesi te autorizuar te emeruar ne menyren e percaktuar me ligji me te drejte riemerimi.

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit esperti kontabel i regjistruar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Esperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se njejte te emerimit.

### Neni 18 Fitimet

Fitimet neto qe rezultojne nga bilanci vjetor, zbritur 5% (pese perqind) qe caktohen per rezerven ligjore deri ne 10% (dhjete per qind) te kapitalit themeltar, dhe gjithashtu te gjitha shumat e tjera qe Asambleja vendos t'i vere menjane, u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara respektivisht.

Asambleja mund te vendose edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo edhe shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

## Kreu V PRISHJA - RIORGANIZIMI I SHOQERISE

### Neni 19 Prishja dhe Likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- 4) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me pikën 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "per Qendren Kombetare te





Registrit";

d) me vendim te gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishia e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtin te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortakët nuk marrin nje vendim per emërimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

#### **Nen 20**

##### **Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblesë se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesën IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

#### **Neni 21**

##### **Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me këte statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 22**

##### **Mosmarveshjet**

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

U lexua, u nenshkrua dhe u firmos.

### **O R T A K Ë T E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Albanian Soul" shpk**

**Gent FEZO**

**(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)**

